L I G J
Nr.8067, datë 15.2.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7926, DATË 20.4.1995 "PËR TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", paragrafi i parë i nenit 7 ndryshohet si vijon:

"Regjistrimi i shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare, duhet të kryhet gjer më 30.6.1996".

Neni 2

Paragrafi i fundit i nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 109 i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", nuk zbatohet për rastet kur të punësuarit e shoqërisë janë bërë njëherazi edhe aksionistë të saj, si pasojë e shitjes së aksioneve të shtetit".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1387, datë 29.2.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha